



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.12.2020

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË
MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(KËSHILLI I MINISTRAVE) DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS, PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT AKADEMIK “FULBRIGHT””**

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2020, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “FULBRIGHT”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë projektligj, znj. Evis Kushi.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.**

Memorandumi i mirëkuptimit, që parashikohet të ratifikohet me këtë projektligj, parashikon bashkëpunimin midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zbatimin e programit të shkëmbimit akademik *“Fulbright”* në arsim, kulturë, shkencë dhe kërkim, me qëllim realizimin e përfitimeve të ndërsjella ndërmjet palëve.

Ky memorandum synon nxitjen e mirëkuptimit e të miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve në arsim, shkencë e kërkim; inkurajon bashkëpunimin në kuadër të përmirësimit të kualifikimeve të studentëve, personelit akademik e profesionistëve për nxitjen e mëtejshme të projekteve të përbashkëta.

Programi *“Fulbright”* u themelua në vitin 1945 dhe mbështet shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin mes Shteteve të Bashkuara dhe mbi 155 vendeve në mbarë botën.

Me anë të këtij memorandum mirëkuptimi synohet që, çdo vit, të përzgjidhen studentë, personel akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe të koordinohet dërgimi i studentëve, personelit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në institucionet akademike apo institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për studime, kërkime apo stazhe akademike. Pala shqiptare do të ketë përfaqësues në komisionin përzgjedhës pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë për të përzgjedhur studentët, personelin akademik dhe profesionistët që do të marrin pjesë në programin *“Fulbright”*.

Gjatë zbatimit të këtij memorandum, pala shqiptare synon të nxisë institucionet arsimore, kulturore, shkencore e kërkimore që të mundësojnë kushtet më të favorshme të mundshme për zbatimin e programit *“Fulbright”* në Republikën e Shqipërisë.

Pala shqiptare synon të koordinojë aprovimin në kohën e duhur dhe lëshimin e dokumenteve ligjore të nevojshme për studentët, personelin akademik dhe profesionistët, për pjesëmarrjen në programin *“Fulbright”* në Republikën e Shqipërisë.

Palët shkëmbejnë informacion dhe planifikojnë rreth pjesëmarrjes së institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore duke i dhënë përparësi nevojave të tyre, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

- ***Efektet financiare.***

Ratifikimi i këtij memorandum do të sjellë efekte financiare në shumën 150 mijë euro në vit, të cilat do të përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet fondit të bursave të ekselencës. Kontributi do të paguhet duke filluar nga viti akademik 2019-2020, deri në vitin akademik 2024-2025, ndërsa pranimi do të fillojë nga viti akademik 2020-2021 dhe në vijim.

- ***Diskutimi në Komision.***

Zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë paraqiti projektligjin, duke u ndalur në rolin që ai do të ketë në fushat e arsimit, shkencës dhe kërkimit. Gjatë diskutimit Komisioni e vlerësoi projektligjin mjaft të rëndësishëm, i cili do të sjellë përfitime shumë të mëdha për shtetasit shqiptarë që kërkojnë të arsimohen në SHBA, si dhe për rritjen e cilësisë së profesionistëve.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në këto argumente, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORJA

Evis KUSHI

KRYETARI

Arben AHMETAJ